

GJETJET NDER SEKTORIALE NGA FORUMET E PULSIT TË KOMUNITETIT NË VERI TË KOSOVËS

Publikuar nga:

Nisma e Re Sociale – NSI

www.newsocialinitiative.org

Autore:

Milica Radovanović

Mars 2026, Mitrovica Veriu

“Ky projekt mbështet arritjen e Objektivave të mëposhtme të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG): Barazia Gjinore; Reduktimi i Pabarazive; Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta; Partneritetet për Objektivat.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në video janë vetëm të pjesëmarrësve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e United Nations, përfshirë United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK), apo të partnerëve zbatues të UNMIK-ut, NSI.”

Gjatë periudhës tetor–nëntor 2025, në veri të Kosovës u mbajtë një seri forumesh të titulluara “Pulsi i Komunitetit”, të cilat mbledhën aktorë të ndryshëm lokalë për të diskutuar mbi sfidat e përditshme që lidhen me qeverisjen lokale, sigurinë, qasjen në shërbime dhe marrëdhëniet ndëretnike. Bisedimet u zhvilluan në **Mitrovicën e Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok**, duke ofruar hapësirë për dialog të hapur në nivel lokal, në një kohë me tensione të shtuara politike dhe pasiguri institucionale.

Kjo përmbledhje e shkurtër paraqet **gjetjet kryesore ndërsektoriale** që kanë dalë nga të tri forumet. Megjithëse kontekstet dhe përvojat lokale ndryshonin, pjesëmarrësit artikulluan shqetësime shumë të ngjashme, duke treguar për probleme të përbashkëta strukturore që vazhdojnë të ndikojnë në jetën e përditshme në veri të Kosovës.

Në të gjitha forumet, pjesëmarrësit përshkruan një ndjenjë të thellë të **degradimit institucional, pasigurisë dhe stagnimit të zgjatur**. Shumë pjesëmarrës shprehën ndjenjën se jeta e përditshme po formësohet më pak nga rregulla të qarta dhe institucione të parashikueshme, e më shumë nga pasiguria, vendimarrja ad hoc dhe konsideratat politike. Ky mjedis gjerësisht u konsiderua si veçanërisht i dëmshëm për të rinjtë, të cilët shohin gjithnjë e më shumë mundësi të kufizuara për stabilitet ose planifikim afatgjatë.

Një temë mbizotëruese ishte **dobësimi i besimit në institucione**, veçanërisht në polici, në sistemin gjyqësor dhe në organet administrative. Pjesëmarrësit theksuan vazhdimisht se institucionet nuk perceptohen më si ofrues të mbrojtjes dhe shërbimeve publike, por përkundrazi si të paparashikueshme, selektive dhe, herë pas here edhe shtrënguese. Pjesëmarrësit ndanë një sërë shembujsh të policimit të tepruar, gjobave arbitrare, ngacmimeve dhe sjelljeve diskriminuese, të cilat kontribuojnë në krijimin e një klime të përgjithshme të frikës dhe pasigurisë. Gratë, fëmijët dhe grupet e tjera të cenueshme u identifikuan si veçanërisht të ekspozuara, ndërsa shumë raste ngacmimi apo dhune mbeten pa u raportuar për shkak të mungesës së besimit dhe reagimit të pamjaftueshëm institucional.

E lidhur ngushtë me këtë ishte edhe përvoja e **përbashkët e përjashtimit administrativ dhe e pasigurisë juridike**. Pjesëmarrësit nga të gjitha komunat përshkruan vështirësi të vazhdueshme në sigurimin e dokumenteve personale, regjistrimin e pronës, verifikimin e diplomave dhe qasjen në përfitime sociale. Barrierat gjuhësore – veçanërisht mungesa e komunikimit adekuat në gjuhën serbe në institucione – u përmendën vazhdimisht si pengesë praktike dhe si simbol i përjashtimit. Këto sfida administrative u konsideruan se kufizojnë drejtpërdrejt mundësitë për punësim, qasjen në shërbime dhe pjesëmarrjen e plotë në jetën publike.

Një tjetër shqetësim i përsëritur ishte ndjenja e të jetuarit “**mes dy sistemeve**”, pa një përfshirje domethënëse në asnjërën prej kornizave institucionale, as të Kosovës e as të Serbisë. Ky dualitet ka krijuar një situatë të zgjatur të paqartësisë, ku qytetarët shpesh mbështeten në zgjidhje joformale, lidhje personale apo ndërmjetësim politik, në vend të rregullave të parashikueshme. Pjesëmarrësit theksuan se kjo gjendje ushqen apatinë, dekurajon angazhimin qytetar dhe forcon perceptimin se përpjekjet individuale nuk mund të çojnë në ndryshime domethënëse.

Pasiguria ekonomike dhe shpopullimi u paraqitën si sfida kryesore ndërsektoriale. Papunësia e lartë, mungesa e investimeve, presioni mbi bizneset e vogla dhe mundësitë e kufizuara – veçanërisht në zonat rurale – u identifikuan si shtytës kryesorë të migrimit. Pjesëmarrësit paralajmëruan se gjithnjë e më shumë të rinjtë nuk po shohin të ardhme në komunitetet e tyre dhe po largohen në numër gjithnjë e më të madh. Mungesa e hapësirave kulturore, sportive dhe të orientuara për të rinjtë u theksua si një faktor që përshpejton edhe më shumë mosangazhimin dhe emigrimin.

Diskutimet po ashtu vunë në pah një pakënaqësi të gjerë me **përfaqësimin dhe udhëheqjen politike**, si në nivel lokal ashtu edhe atë qendror. Pjesëmarrësit shprehën mosbesim ndaj elitave politike, si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd, duke e përshkruar vendimmarrjen si jo transparente, të centralizuar dhe të shkëputur nga realitetet lokale. Proceset zgjedhore shpesh u panë me skepticizëm, ku pjesëmarrësit vinin në dyshim nëse rezultatet e zgjedhjeve pasqyrojnë vërtet besimin e qytetarëve apo më shumë, presionet strukturore dhe alternativat e kufizuara. Moszbatimi i zotimeve kryesore politike – veçanërisht i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe – është përmendur vazhdimisht si një simbol i premtimeve të pa mbajtura dhe i paralizës institucionale.

Marrëdhëniet ndëretnike u përshkruan gjerësisht si të brishta dhe në përkeqësim. Derisa ndërveprimet e përditshme ndërpersonale mund të mbeten funksionale, pjesëmarrësit u pajtuan se praktikrat institucionale, qeverisja e orientuar drejt sigurisë, retorika nacionaliste dhe narrativat mediatike kanë dobësuar ndjeshëm besimin ndërmjet komuniteteve. Disa pjesëmarrës theksuan se bashkëjetesa është e mundur dhe ka ekzistuar në praktikë, por instrumentalizimi politik i identitetit vazhdon të minojë kohezionin shoqëror dhe të forcojë ndjenjën e frikës.

Pavarësisht pesimizmit të përhapur, pjesëmarrësit në të gjitha forumet theksuan rëndësinë e **dialogut dhe angazhimit në nivel lokal**. Diskutimet në kuadër të “Pulsit të Komunitetit” u vlerësuan si hapësira të rralla ku pjesëmarrësit mund të shprehnin hapur frustrimet e tyre, të identifikonin problemet e përbashkëta dhe të diskutonin ide konstruktive përtej ndarjeve etnike dhe politike. Pjesëmarrësit theksuan vazhdimisht se rikthimi i besimit – veçanërisht në institucione – përmirësimi i komunikimit, mbrojtja e grupeve të cënueshme dhe përqendrimi në përmirësime pragmatike në jetën e përditshme janë parakushte thelbësore për stabilitet.

Në përgjithësi, diskutimet e kombinuara paraqesin veriun e Kosovës si një hapësirë të karakterizuar nga **brishtësi institucionale, lodhje shoqërore dhe rënie të besimit në zgjidhjet politike**. Në të njëjtën kohë, ato nxjerrin në pah dëshirën e vazhdueshme të qytetarëve për normalitet, dinjitet dhe siguri, si dhe një vetëdije të qartë se pa qeverisje gjithëpërfshirëse, institucione transparente dhe angazhim të qëndrueshëm, trendet aktuale të mosangazhimit dhe emigrimit ka të ngjarë të vazhdojnë.

